




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
	
Nr. Prot. <u>D-9</u> Br. Prot. <u>01-3026/11/a</u> Prot No. <u>01-3026/11/a</u> Data <u>24.06.2011</u> Datum <u>24.06.2011</u> Nr. pages _____ PRISHTINE	Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

22.06.2011

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 45 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit merr këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti me nr. protokolli: AKK – 03-364 / 2011, i trajtuar për konflikt interesi për zyrtarin, Z. Bajram Zogiani – Gjyqtar porot në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

A r s y e t i m

Në rastin e shqyrtuar për Konflikt Interesi, me nr. protokolli AKK-03-364 / 2011, është vërtetuar se ka pasur prova të mjaftueshme që kanë argumentuar gjendjen e konflikti të interesit, prandaj zyrtarit të lartpërmendur i është bërë shkresa njoftuese dhe nga ai është kërkuar shmangia e situatës konflikt interesi.

Zyrtari brenda afatit ligjor për ta shmangur situatën konflikt interesi, ka sjell dëshmi që ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit publik si Gjyqtar porot në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për të ushtruar funksionin e tij si Anëtar i Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Njoftimin për dorëheqje e ka dërguar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe te ne në Agjenci. Pas këtyre ndryshimeve që i ka bërë Zyrtari i lartë, d.m.th.heqja dorë nga ushtrimi i njërit nga funksionet publike, Agjencia kundër korrupsionit ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit të DP-së
- Zyrtarit përgjegjës
- Zyrtarit ndihmës

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni

